

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Ushtarët zëvendësohen, Mbretëresha JO"/ Belinda Balluku DREJTON edhe pas largimit: "Nëse je mike shë e shefes..." Gazeta Shqip
ADRESA	https://gazeta-shqip.com/me-rendesi/ushtar-et-zevendesohen-mbreteresha-jo-belinda-balluku-drejtton-edhe-pas-largimit-nese-je-mikeshe-e-shefes/
BURIMI	gazeta-shqip.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 14:34:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 11:30:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cba51b70f3f8dddfdeec9bc6d6c0b97db1991c959797f610c7310300bd49d5ec
TEKSTI	6b3c8487d8593651fc5b8644337808ec210cf9dd373a774b3849060081264366
PAMJA	59399eb3a6b523d75935c2af448a7f88a81575c1d1ffae6c1acf73ebe1881793

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	804a9e32ecd172c2af2c74abf27e96c4f1ff39e24daa53a44e6f30a36ea6462f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	da6b05e5b6a4871f38e77322a1aea555a613f6543c156d05714d243b2008ce80
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/804a9e32ecd172c2af2c74abf27e96c4f1ff39e24daa53a44e6f30a36ea6462f

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ME RËNDËSI

“Ushtarët zëvendësohen, Mbretëresha JO”/ Belinda Balluku DREJTON edhe pas largimit: “Nëse je mikeshë e shefes...”



10:30 | 29 SHTATOR 2026

SHPERNDA ▾

Një investigim i Fiks Fare ka sjellë dëshmi dhe biseda të regjistruara me drejtues të disa institucioneve shtetërore, në të cilat emri i Belinda Ballukut vijon të përmendet në lidhje me emërime dhe mundësi punësimi, pavarësisht largimit të saj nga posti i ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gazetarja e emisionit është prezantuar si një person në kërkim të një vendi pune dhe ka kontaktuar drejtues të disa institucioneve në varësi apo të lidhura me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Nga Autoriteti i Aviacionit Civil, te Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, në bisedat e publikuara nga Fiks Fare emri i Ballukut shfaqet disa herë.

Në Autoritetin e Aviacionit Civil, gazetarja kontaktoi drejtorin Maksim Et'hemaj dhe i shprehu interesin për t'u punësuar në sektorin e medias. Gjatë bisedës për personin që mbante aktualisht këtë pozicion, Et'hemaj iu referua mundësisë së një emri tjetër të propozuar nga Balluku.

Investigimi vijoi në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial, ku gazetarja zhvilloi një bisedë me drejtorin Sokol Zajmi. Në materialin e transmetuar, Zajmi përdor termin “shefja” dhe, sipas kontekstit të bisedës së publikuar nga Fiks Fare, i referohet Ballukut.

“Nëse je mikesha e shefes, je dhe e imja”, dëgjohet të shprehet ai.

Gjatë së njëjtës bisedë, drejtori përdor edhe një metaforë tjetër: “Ushtarët zëvendësohen kollaj, po mbretëresha nuk zëvendësohet dot.”

Një tjetër episod i investigimit zhvillohet në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera. Drejtori Rrapush Tola, gjatë bisedës me gazetaren, pretendon se Balluku ka pasur rol në vendosjen e Enea Karakaçit në drejtimin e ministrisë. Sipas materialit të publikuar, ai lë gjithashtu të kuptohet se një ndërhyrje nga ish-ministrja mund të kishte ndikim edhe për kërkesën e gazetares për punësim.

Fiks Fare ka ndjekur më tej gjurmën brenda vetë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, duke kontaktuar Flor Serjanin, ish-këshilltar të Ballukut, i cili vijonte të punonte në ministri në kohën kur është realizuar investigimi.

Serjani konfirmon se vazhdon të jetë në detyrë dhe thotë se merret gjithashtu me marrëdhëniet me publikun të Ballukut. Gjatë një takimi me gazetaren në ambientet e ministrisë, ai flet edhe për drejtues të agjencive në varësi.

Sipas deklarimeve të tij të transmetuara nga Fiks Fare, disa prej drejtuesve janë zgjedhur pas sugjerimeve apo ndërhyrjeve të Ballukut. Mes tyre ai përmend edhe drejtuesin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Serjani pohon gjithashtu se ishte takuar me Ballukun vetëm dy ditë përpara bisedës së tij me gazetaren.

Pas këtyre deklaratave, Fiks Fare kontaktoi edhe drejtorin e AKBN-së, Genci Tërpo. Ky i fundit konfirmoi se kishte zhvilluar një takim me Ballukun në fund të muajit gusht.

Kur gazetarja i kërkon që t'i përcjellë të fala ish-ministres, ai pranon, ndërsa në lidhje me kërkesën për punësim shprehet se do ta shohë situatën.

Në përfundim të investigimit, gazetarët kërkuar një reagim drejtpërdrejt edhe nga Belinda Balluku, duke e pyetur për deklaratat e drejtuesve që vijonin t'i referoheshin asaj si “shefe” dhe për pretendimet mbi ndikimin e saj në institucione.

Balluku nuk iu përgjigj drejtpërdrejt pyetjeve mbi këto pretendime. Ajo kundërshtoi mënyrën se si po ndiqej nga gazetarët dhe akuzoi emisionin për “cinohëvënie” ndërsa në një moment iu drejtua gazetares me fjalët:

“Mos u bëj gjobaxhie.”

Materialet e transmetuara nga Fiks Fare ngrenë pikëpyetje mbi raportet që Balluku ruan me ish-vartësit dhe drejtuesit e institucioneve pas largimit nga posti. Deklaratat e regjistruara përbëjnë pretendime të personave të intervistuar dhe, në vetvete, nuk provojnë se Balluku ka ushtruar kompetenca zyrtare apo ka marrë vendime institucionale pas largimit nga detyra.



GAZETA SHQIP

Rreth nesh
Marketing
Newsletter
Mundësi Punësimi
Kontakt

TOP ALBANIA RADIO

News
Shows
Video
Podcasts

MORE

Top Channel
TimeOutTirana
Top Music Awards

SOCIAL



Newsletter

Regjistrohu

[Privacy Policy & Terms of Use](#) | [Cookie Policy](#)

gazeta shqip

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.